



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.744/14 prot.

Datë 27/04/2026

V E N D I M

Nr. 554 /2026

komisioni i prokurimit publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27/ 04/2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” Sh.p.k në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e larte monetar – shërbime – marrëveshje kuadër me 1 operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-73202-12-23-2025, me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të SHRUKD”, me fond limit 25.097.400,00 (*Njëzet e pesë million e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind*) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha.

Lënie në fuqi të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për Skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “Albdesign” Shpk në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues: Operatori ekonomik “Adel Co” Shpk me NUIS L22117021M, me adresë: Rruga Efendiu, Nr. 13, Tiranë, 1050.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sha, *me adresë: L.17 Rruga Dalip Peza, Durrës.*

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Inpress Sh.p.k”, *me NUIS L52122014L, me adresë: Ish blloku i magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra, Tiranë.*

Operatori ekonomik “Albdesign Sh.p.k” *me NUIS L51819005Q, me adresë: Kashar, Tirane Rruga "Çerçiz Topulli", objekti Nr.17.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e larte monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga te gjithë anëtarët, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24-12-2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e larte monetar – shërbime – marrëveshje kuadër me 1 operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73202-12-23-2025, me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të SHRUKD”, me fond limit 25.097.400,00 (Njëzet e pesë million e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha.

II.2 Në datën 03.02.2026 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1.“Inpress”shpk	19061800.00 lekë	Kualifikuar
2.“Albdesign PSP” shpk	22156000.00 lekë	Skualifikuar
3.“Adel CO” shpk	25021000.00 lekë	Kualifikuar

II.3. Në datën 27.02.2026 Autoriteti Kontraktor ka publikuar Njoftim fituesin paraprak e procedurës së prokurimit në sistemin të prokurimeve elektronike (S.P.E.).

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2026/6400, datë 09.03.2026 dhe me nr.744/2026 Prot., dhe protokolluar me datë 09.03.2026 e operatorit ekonomik “Adel CO ”shpk , duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inpress” shpk dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Albdesign PSP” shpk.

II.5 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 744/1 prot., datë 10.03.2026, janë

publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e me pretendimet e paraqitura nga ankimuesi.

II.6 Më datë 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha, nëpërmjet shkresës me nr. 353/13, datë 12.03.2026, me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik*”, në lidhje me vlerësimin ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Adel Co” shpk, për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton se nuk e ka pranuar ankesën e paraqitur.

II.7 Më datë 13.03.2026 nga “Adel Co” shpk, nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr. 744/3, datë 13.03.2026, me objekt “*Shtesë ankese e shoqërisë ADEL CO shpk...*”, Adel CO ka paraqitur shtesë ankesën nëpërmjet shërbimit postar për procedurën objekt – ankimi.

II.8 Më datë 17.03.2026 nga “Adel Co” shpk, nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr. 744/5, si dhe me shkresën protokolluar me tonën 744/ 4 datë 13.03.2026, me objekt “*Mbi vendimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesave për procedurën objekt ankimi...*”, Adel CO ka paraqitur kundërshtime ndaj vendimit të KSHA për ankesën objekt shqyrtimi.

II.9 Më datë 17.03.2026 nga “Adel Co” shpk, nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr. 744/6, autoriteti kontraktor ka paraqitur shkresë për dijeni me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik Adel Co*” shpk lidhur me ankesën për procedurën objekt – ankimi.

II.10 Më datë 01.04.2026 Komisioni i është drejtuar autoritetit kontraktor nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr. 744/8, me lëndë mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni lidhur me trajtimin e ankesës dorëzimin e dokumentave të operatorit ekonomik të parë dhe mostrat, lidhur me ankesën për procedurën objekt – ankimi.

II.11 Më datë 10.04.2026 autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr. 744/11, ka përcjellë pranë Komisionit mostrat e depozituara nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, lidhur me ankesën për procedurën objekt – ankimi.

II.12. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga operatori ekonomik “Inpress” shpk, me nr.744/7 prot., datë 18.03.2026 lidhur me ankesën e paraqitur, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Adel Co” shpk, mbi vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së “Inpress” shpk, me arsyet se:...[3 Ne pikën 2.3.1 të Aftësisë Teknike dhe Profesionale është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate . Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. OE duhet t? paraqes? d?shmi p?r sh?rbimet e m?parshme t? ngjashme, t? realizuara gjat? tre viteve t? fundit, nga data e shpalljes s? njoftimit t? kontrat?s, n? nj? vler? jo m? t? vog?l se 40% e fondit limit.

Firma Inpress nuk e plot?son k?t? kriter, pasi ajo ka paraqitur disa formular? t? thjesht?, shtypshkrime t? ndryshme q? nuk p?rputhen me objektin e prokurimit dhe nuk mund t? konsiderohen si sh?rbime t? ngjashme.

Gjithashtu, firma Inpress nuk ka dor?zuar v?rtetime nga institucione publike q? t? mbeshtesin vler?n e k?rkuar dhe q? t? jen? n? p?rputhje me objektin e prokurimit.

Duke e njohur shum? mir? k?t? firme ne ju garantojme q? d?shmit? p?r pun? t? ngjashme jan? shtypshkrime dhe nuk e plot?sojn? shum?n e k?rkuar n? dokumentet e tenderit p?r arsye se shtypshkrimet ndryshojn? shum? si n? proçes edhe n? makineri, ku shtypshkrimet realizohen me makineri offset kurse fatura selfmail realizohen me printera dixhital. Pra, firma Inpress nuk ka kontrata t? ngjashme t? k?tij karakteri, p?r arsye se firmat private nuk kan? tirazhe t? tilla p?r faturat selfmail. P?rsa m? sip?r, firma Inpress nuk e plot?son pik?n 2.3.1 t? pun?ve t? ngjashme dhe duhet t? skualifikohet nga kjo proçedur? prokurimi...]

III.1.1 Në pikën 2.3.1 të Dokumentave standarte të tenderit shtojca 9, Autoriteti kontraktor ka parashikuar “1. Aftësitë teknike dhe profesionale, si në vijim,

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara .

III.1.2. Neni 2 “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.6. Në përmbushje të kriterit sipërpemdur, operatori ekonomik “Inpress” shpk ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim nr. 1659/1 prot., datë 16.07.2025, nga Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Gjirokastë sha, me anë të së cilës vërtetohet se janë realizuar kontratat e mëposhtme nga OE “Inpress” shpk Kontrata menr 455/16 prot datë 15.02.2023 “Shërbim printimi dhe zarfimi të faturave”, me cmim kontrate 1,675.800 lekë pa tvsh si dhe kontrata me nr. 1292/12 prot., 31.05.2024 dhe cmim kontrate 1,099.026 lekë pa tvsh.*
- *Numri i faturës: 31/2022, data 01.03.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail Shuma totale pa TVSH 1 675 740,75 ALL;*
- *Numri i faturës: 42/2022, data 01.04.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail Shuma totale pa TVSH 3 447 620,85;*
- *Numri i faturës:54/2022,data 04.05.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail Shuma totale pa TVSH,3 437 479,30 ALL;*

- Numri i faturës: 74/2022, data 01.06.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail Shuma totale pa TVSH 3 436 869,80 ALL;
- Numri i faturës: 113/2022 data 01.07.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmai Shuma totale pa TVSH, 3 445 967,25 ALL;
- Numri i faturës: 118/2022, Data 08.07.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmai Shuma totale pa TVSH , 876 654,45 ALL;
- Numri i faturës: 5/2023 data 10.01.2023 Printim te dhenash variabel dhe zarfim(insertim automatik) Shuma totale pa TVSH 333 877,33 ALL ;
- Numri i faturës: 8/2023 data 17.01.2023 Sherbim logimi dhe stampimi,materiale promocionale, Shuma totale pa TVSH 298 500,83 ;
- Numri i faturës: 27/2023 data 28.02.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail, Shuma totale pa TVSH 504 166,67;
- Numri i faturës: 41/2023 data 21.03.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmai Shuma totale pa TVSH 606 585,00;
- Numri i faturës: 23/2022 data 01.02.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmai Shuma totale pa TVSH 1 719 672,45;
- Numri i faturës: 22/2023,data 09.02.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmai Shuma totale pa TVSH 1 537 500,00;
- Numri i faturës: 78/2021,data 12.10.2021 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 100 012,00;
- Numri i faturës: 106/2021 data 15.11.2021 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 101 640,00;
- Numri i faturës: 130/2021 data 16.12.2021 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 102 524,40;
- Numri i faturës: 52/2021 data 13.09.2021 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 101 816,00;
- Numri i faturës: 47/2022 14.04.2022 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 102 858,80 ALL;
- Numri i faturës: 10/2022 data 17.01.2022 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 102 414,40 ALL;

- *Numri i faturës: 28/2022; data 11.02.2022 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 102 894,00 ALL;*
- *Numri i faturës: 39/2022,data 17.03.2022 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 102 894,00 ALL;*
- *Numri i faturës: 57/2022 data 13.05.2022 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 102 916,00 ALL;*
- *Numri i faturës: 87/2022 data 10.06.2022 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 103 004,00 ALL;*
- *Numri i faturës: 124/2022 data 15.07.2022 Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 103 096,40 ALL;*
- *Numri i faturës: 142/2022 ,Data 11.08.2022 , Printim dhe zarfim i faturave te ujit te pijshem te sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje Shuma totale pa TVSH 103 281,20 ALL;*
- *Numri i faturës: 81/2021 Data 12.10.2021 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 156 353,40 ALL;*
- *Numri i faturës: 103/2021 Data 09.11.2021 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 160 414,80 ALL;*
- *Numri i faturës: 128/2021, data 16.12.2021 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 155 996,40 ALL;*
- *Numri i faturës: 29/2022 Data11.02.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 161 128,80 ALL;*
- *Numri i faturës: 37/2022 15.03.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 159 318,60 ALL; Numri i faturës: 46/2022 11.04.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 157 437,00 ALL;*
- *Numri i faturës: 58/2022 13.05.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 161 208,60;*
- *Numri i faturës: 86/2022 Data 10.06.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 162 464,40 ALL;*
- *Numri i faturës: 123/2022 15.07.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 160 209,00 ALL;*
- *Numri i faturës: 141/2022 11.08.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 161 658,00;*

- *Numri i faturës: 175/2022 Data 09.09.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 162 002,40 ALL;*
- *Numri i faturës: 2/2022 Data 11.01.2022 Sherbim printimi faturash Shuma totale pa TVSH 163 182,60 ALL.*
- *Numri i faturës: 61/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 29.04.2023 Printimi i fatures te energjise elektrike dhe zarfimi ne version Selmailer 1 395 164,04 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 78/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 25.05.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 353 907,44*
- *Numri i faturës: 85/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 23.06.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 1 152 507,22 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 95/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 31.07.2023 Printimi i fatures te energjise elektrike dhe zarfimi ne version Selmaile 1 993 087,20 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 97/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 04.08.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 723 270,08 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 101/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 21.08.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 313 263,28 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 135/2022 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 02.08.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 2 483 327,79 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 160/2022 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 01.09.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 321 171,92 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 225/2022 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 03.10.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 329 442,16 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 252/2022 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 26.10.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 327 430,48 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 279/2022 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 22.11.2022 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 355 952,14 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 1/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 04.01.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 338 901,08 lek pa tvsh*
- *Numri i faturës: 20/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 09.02.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 336 383,98 lek pa tvsh*

- *Numri i faturës: 28/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 01.03.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 342 017,70 lek pa tvsh.*

III.1.7. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.2 ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Referuar dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik "Inpress shpk" SHPK, në SPE, por edhe dokumentave provuese të përcjella nga AK, Komisioni pasi i mori në shqyrtim dhe në analizë të gjitha faturat tatimore shitjeje me subjekte private dhe për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, kontratat të shoqëruara me vërtetime të

lëshuara nga entet publike, konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar në SPE si edhe në formë shkresore është në përmbushje të kriterit kualifikues, operatori ekonomik ka paraqitur faturat dhe kontratat të sipërcituara ne piken III.1.6 , ku rezulton në përmbushje të kriterit 2.3.2, (kriteri kualifikues sipërcituar). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon referuar fakteve, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, 2.3,2 kapaciteti teknik, në lidhje: Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten: Në rastin e përvojës se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen, për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Gjithashtu Komisioni i prokurimit publik referuar verifikimit të faturave të kontratave të mëparshme, konkretisht faturat e vlefshme si në vijim: Vërtetim mr nr. 1659/1 prot., datë 16.07.2025, nga Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastë sha, me anë të së cilës vërtetohet se janë realizuar kontratat e mëposhtme nga OE “Inpress” shpk Kontrata menr 455/16 prot datë 15.02.2023 “Shërbim printimi dhe zarfimi të faturave”, me cmim kontrate 1,675.800 lekë pa tvsh si dhe kontrata me nr. 1292/12 prot., 31.05.2024 dhe cmim kontrate 1,099.026 lekë pa tvsh.; Numri i faturës: 5/2023 data 10.01.2023 Printim te dhenash variabel dhe zarfim(insertim automatik) Shuma totale pa TVSH 333 877,33 ALL ; Numri i faturës: 8/2023 data 17.01.2023 Sherbim logimi dhe stampimi,materiale promocionale, Shuma totale pa TVSH 298 500,83 ; Numri i faturës: 27/2023 data 28.02.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail, Shuma totale pa TVSH 504 166,67;Numri i faturës: 41/2023 data 21.03.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmai Shuma totale pa TVSH 606 585,00; Numri i faturës: 22/2023,data 09.02.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmai Shuma totale pa TVSH 1 537 500,00; Numri i faturës: 61/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 29.04.2023 Printimi i fatures te energjise elektrike dhe zarfimi ne version Selmaile 1 395 164,04,Numri i faturës: 78/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 25.05.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 353 907,44,Numri i faturës: 85/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 23.06.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 1 152 507,22, Numri i faturës: 95/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 31.07.2023 Printimi i fatures te energjise elektrike dhe zarfimi ne version Selmaile 1 993 087,20, Numri i faturës: 97/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 04.08.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 723 270,08,Numri i faturës: 101/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 21.08.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 313 263,28 ,Numri i faturës: 1/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 04.01.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 338 901,08,Numri i faturës: 20/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 09.02.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3 336 383,98,Numri i faturës: 28/2023 Data dhe ora e lëshimit të faturës: 01.03.2023 Printim te dhena variabel dhe zarfim ne versionin selmail 3

342 017,70 lek PA TVSH , duke pasur parasysh natyrën e objektit të tyre si dhe periudhën kohore rezulton se operatori ekonomik e tejkalon vlerën, jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit e cila është përkatësisht 25.097.400,00 (Njëzet e pesë million e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) Lekë pa TVSH. Nga analiza dhe verifikimi i faturave të sipërpërmendura, rezulton se e ka realizuar me sukses kriterin e sipërmendur ku gjithashtu duke ju referuar komponentit kohë dhe natyrë .

Për sa më sipër referuar, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Adel CO” shpk , me arsye se :

...[“1. 2 N? Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në pikën 2.3.8 është kërkuar: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: ? 3 (tre) makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes, ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH ? Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitetjo me pak se prej jo më pak se 1041 fletë A4/ore të printuara nga te dyja anët. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. a-) Sipas pikës m? sipër jan? kërkuar 3 makineri, njëkohsisht këto makineri duhet të shoqërohen me 3 kartela teknike. Nga informacionet që kemi firma Inpress ashtu si edhe në tenderat e tjerë ka paraqitur faturën nr. 904/22 Ricoh 8110. Ne mendojme se KVO-ja në gjykim ka qënë e njëanshme sepse duke iu referuar njoftimit të fituesit të vitit 2023 dhe duke qënë plotësisht të bindur që firma Inpress ka paraqitur të njëjtat dokumente, firma Inpress në vitin 2023 është skualifikuar sepse në faturën 904/22 të marrë nga firma Kallfa Printer Ricoh 8110 dhe sipas dokumenteve të tenderit duhet të shoqërohet me kartelën teknike Ricoh 8110 në përmbushje të pikës 2.3.8 të DST-së. Në vitin 2023 KVO e ngritur nga SHRUKD ka konstatuar këtë mangësi sepse në njoftimin e fituesit për të njëjtën procedurë për skualifikimin e firmës Inpress në vitin 2023 thuhet: Inpress është skualifikuar: OE nuk përmbush: ? Kapacitetin teknik pika 2.3.8 / pasi; ? Kartelat teknike të paraqitura për makinerinë sipas faturës Nr.904/22 Printer Ricoh 8110 , nuk janë për këtë pajisje por për Ricoh Pro 8110EX dhe 8110S. Pra, çfarë ka ndryshuar në vitin 2026 që nuk është skualifikuar kur dihet ligjërisht që në vitin 2023 dhe në vitin 2026. Pra, kartela e paraqitur nga firma Inpress nuk i korrespondon printerit sipas faturës 904/22 dhe për të përmbushur pikën 2.3.8 të DST-së duhet të paraqesë kartelën teknike të printerit Ricoh 8110 dhe jo të printerit Ricoh 8110EX. Por ne ju garantojme se nuk ekziston modeli Ricoh 8110. Operatori ekonomik Inpress ka paraqitur në dokumentacionin e tij një mospërputhje thelbësore

ndërmjet modelit të pajisjes së faturuar dhe dokumentacionit teknik të dorëzuar, pasi nuk ekziston pajisje Ricoh 8110 . Në faturën tatimore është pajisja Ricoh 8110 , pa specifikimin Pro apo S , sepse një pajisje e tillë nuk ekziston. Fatura e paraqitur nga firma Inpress për pajisjen e blerë nga firma Kallfa me nr. 904/22 nuk është makineri dixhitale pasi firma Ricoh nuk ka makineri dixhitale të prodhuar me këtë numër, fakt ky që shihet edhe nga kartela e paraqitur nga firma Inpress. Në këtë rrethana duke që nëse kjo makineri nuk njihet dhe nuk e ka emertimin kjo faturë është nul dhe nuk duhet të merret në konsideratë nga KVO-ja, pra KVO-ja është treguar e njëanshme. Nga ana tjetër, kartela teknike e paraqitur nga operatori ekonomik nuk i referohet kësaj pajisjeje, pra pajisjes Ricoh 8110 , por është një kartelë teknike e përgjithshme për katër modele të ndryshme: Ricoh Pro 8100EX / 8100S / 8110S / 8120S, pra një kartelë pa e specifikuar se kush nga modelet i takon faturës me nr. 904/22. Kjo situatë krijon paqartësi serioze për përmbushjen e dokumentave të tenderit: 1. Identitetin real të pajisjes së ofertuar dhe të faturuar sepse kjo pajisje nuk ekziston 2. 3. Përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Vlefshmërinë e dokumentacionit teknik, i cili nuk është i dedikuar për modelin konkret të ofruar. Në kushtet kur pajisja e faturuar nuk është identike me asnjë prej modeleve të paraqitura në kartelën teknike dhe vetë kartela përfshin disa modele të ndryshme pajisjesh, rezulton se dokumentacioni teknik i paraqitur është i përgjithshëm dhe jo i personalizuar për pajisjen konkrete të deklaruar në faturë, në kundërshtim me kërkesat e dokumenteve të tenderit atëherë kemi të bëjmë me: ? ? ? Mospërmbushje të kërkesave të dokumentave të tenderit Paraqitje të dokumentacionit teknik të përgjithshëm dhe jo të personalizuar. Shkelje të rregullave të barazisë në garë dhe transparencës. Në këtë kushte, fatura e paraqitur nga Kallfa është nul sepse kjo pajisje nuk ekziston, pasi pajisja e deklaruar nuk ekziston, konkretisht nuk ka model Ricoh 8110 dhe në këto rrethana KVO-ja nuk duhet ta konsideronte këtë faturë si dokument të vlefshëm në këtë procedurë, ashtu siç ka vepruar KVO-ja dhe KPP-ja në vitin 2023 (ku KPP e quajti të drejtë skualifikimin e firmës Inpress). Përse thamë me lart, në një situatë faktike dhe juridike identike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në vitin 2023 ka konstatuar të njëjtën mospërputhje dhe ka vendosur skualifikimin e këtij operatori ekonomik. Një vlerësim i ndryshëm për të njëjtën situatë faktike përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe të parimit të transparencës në procedurat e prokurimit publik, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik . Në praktikën e tij vendimmarrëse, Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar se operatori ekonomik duhet të provojë në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë përmbushjen e kriterëve të kapacitetit teknik, dhe çdo mospërputhje midis dokumentit të pronësisë së pajisjes dhe dokumentacionit teknik e bën të pamundur identifikimin e pajisjes së deklaruar dhe rrjedhimisht kriteri konsiderohet i paprovuar nga ana e operatorit. Për rrjedhojë, në rastin konkret, duke qenë se: ? pajisja e deklaruar në faturë nuk identifikohet qartë si model ekzistues, ? ? kartela teknike nuk i referohet drejtpërdrejt pajisjes së faturuar, dhe dokumentacioni teknik i paraqitur është i përgjithshëm dhe jo specifik për pajisjen konkrete, çka rezulton se operatori ekonomik Inpress nuk ka provuar përmbushjen e kriterit të kapacitetit teknik sipas pikës 2.3.8 të Dokumenteve të Tenderit. Si përfundim, duke qenë se nga 3 makineri të kërkuara, njëra prej tyre nuk provohet me dokumentacion teknik të vlefshëm dhe të përputhshëm me faturën përkatëse sepse pajisja sipas faturës së lëshuar nga shoqëria Kallfa nuk ekziston, pra nuk ka model Ricoh 8110, rezulton se operatori ekonomik Inpress nuk përmbush kapacitetin teknik të kërkuar, dhe për këtë arsye oferta e tij duhet të konsiderohet e papranueshme dhe të skualifikohet nga kjo

procedurë prokurimi. b-) Sipas pikës 2.3.8 të DST-së të cituar më sipër OE pjesëmarrës duhet të disponojnë 3 makineri dixhitale të cilat me anë të dokumentave ligjor të tregonin se disponojnë këto makineri dixhitale. Dokumentet e tenderit kanë si synim kryesor që të shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP ku çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. Në këtë rast, firma Inpress për plotësimin e pikës ka paraqitur një faturë nga firma Sinteza ku shkruhet fotokopje Accurio Press 4070 dhe me anë të kësaj fature kërkohet të plotësojë pikën e mësipërme për makineri dixhitale prodhimi. Por me termin fotokopje nuk plotësohet termi makineri dixhitale që kërkohet në dokumentet e tenderit. Përdorimi i termit fotokopje në faturë krijon paqartësi shumë të madhe në plotësimin e kësaj pike pasi në dokumentet e tenderit është kërkuar makineri dixhitale.

Qëllimi i përcaktimit të këtyre kriterëve në Dokumentet e Tenderit është që të mundësojë autoritetit kontraktor të krijojë një bindje të plotë mbi kapacitetet reale teknike dhe organizative të operatorëve ekonomikë, në mënyrë që të sigurohet se operatori ekonomik fitues është realisht në gjendje të realizojë kontratën sipas kërkesave të procedurës së prokurimit. Në këtë kuadër, operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin dokumentacion të qartë dhe të saktë që provon disponimin e pajisjeve të kërkuara, pasi sipas Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, çdo ofertë që nuk paraqitet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit duhet të konsiderohet e papranueshme dhe të refuzohet. Përdorimi i termit fotokopje në dokumentin që provon disponimin e pajisjes krijon një paqartësi të theksuar dhe të papranueshme lidhur me natyrën reale të pajisjes së deklaruar, pasi një fotokopje zyre nuk mund të konsiderohet makineri dixhitale prodhimi, siç kërkohet nga dokumentet e tenderit. Në një procedurë prokurimi publik, dokumentacioni i paraqitur nga operatorët ekonomikë duhet të jetë i qartë, i saktë dhe pa asnjë paqartësi, pasi çdo paqartësi në dokumentacion interpretohet në disfavor të operatorit ekonomik ofertues, i cili ka barrën për të provuar përmbushjen e kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk mund të krijojë bindjen se një pajisje e identifikuar si fotokopje është e barazvlefshme me një makineri dixhitale prodhimi, e aftë për të realizuar printimin e një tirazhi kaq të madh faturash, siç kërkohet në këtë procedurë prokurimi. Për më tepër, në praktikën e tij vendimmarrëse, Komisioni i Prokurimit Publik ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se çdo pasaktësi ose paqartësi në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit përbën shkak për mospranimin e ofertës, pasi kriteret duhet të provohen në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë. Në këto kushte, operatori ekonomik Inpress nuk ka provuar në mënyrë të qartë se disponon 3 makineri dixhitale, siç kërkohet në pikën 2.3.8 të Dokumenteve të Tenderit, pasi një nga pajisjet e paraqitura është fotokopje zyre dhe jo makineri dixhitale prodhimi. Enti Prokurues e ka përcaktuar qartë që duhet të jenë makineri dixhitale dhe nuk ka sesi të barazohet një makineri dixhitale me një fotokopje zyre. Pra, në dokumentet e tenderit është e përcaktuar qartë dhe saktë që duhet të jenë 3 makineri dixhitale dhe jo fotokopje. Përsa thuhet më lart, firma Inpress nuk e plotëson pikën 2.3.8 të dokumenteve të

tenderit sepse ka paraqitur nj? fotokopje zyre dhe duhet te skualifikohet nga kjo procedure prokurimi. c-)Në lidhje me pikën 2.3.8 të cituar më sipër, përveç paraqitjes së makinerive dixhitale, operatorët ekonomikë duhet të paraqisnin edhe kartelat teknike përkatëse që shoqërojnë secilën prej këtyre makinerive, me qëllim që Enti Prokurues të verifikojë karakteristikat teknike dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Edhe nëse do të konsideronim të vlefshme faturën e paraqitur për makinerinë Ricoh 8110, operatori ekonomik Inpress ka paraqitur një faturë të lëshuar nga shoqëria Kallfa , në të cilën pasqyrohen dy makineri të tipit Ricoh Pro C901S. Këto makineri janë deklaruar gjithashtu edhe në Formularin e Vetëdeklarimit të paraqitur nga ky operator ekonomik, por firma Inpress ka paraqitur vetëm një kartelë teknike për makineritë Ricoh Pro C901S, ndërkohë që sipas faturës dhe Formularit të Vetëdeklarimit rezulton se disponon dy makineri të këtij tipi. Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik , si dhe të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik është i detyruar të paraqesë dokumentacion të plotë për secilën makineri të deklaruar, përfshirë edhe kartelat teknike përkatëse. Pra, për çdo makineri të deklaruar duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës, pavarësisht faktit nëse kartelat teknike janë identike për modele të së njëjtës makineri. Firma Inpress duhet të paraqeste aq kartela teknike sa makineri ka pavarësisht sa të sakta janë ato makineri. Firma Inpress ka paraqitur dy makineri Ricoh Pro C901S, por ka paraqitur vetëm një kartelë teknike, duke mos përmbushur kështu kërkesën e dokumenteve të tenderit për paraqitjen e dokumentacionit të plotë për secilën makineri. Për sa them? m? lart?, duke qenë se dokumentacioni i paraqitur është i paplotë dhe në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.8 të dokumenteve të tenderit, firmes Inpress i mungojne kartelat teknike per makinerite e paraqitura dhe te deklaruar, firm rma Inpress nuk përmbush kriteret e kërkuara dhe duhet të skualifikohet nga procedura e prokurimit. Si p?rfundim: ? Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm dy makineri dixhitale të provuara, dhe jo tre, siç kërkohet në dokumentet e tenderit. ? Pajisja Ricoh 8110 , sipas faturës së lëshuar nga shoqëria Kallfa , nuk rezulton të jetë një model ekzistues pajisjeje. ? Kartela teknike e paraqitur nuk i korrespondon modelit të deklaruar në faturë, por përfshin modele të tjera pajisjesh. ? Pajisja Accurio Press 4070 është fotokopje zyre, dhe jo makineri dixhitale prodhimi, siç kërkohet në dokumentet e tenderit. ? Firma Inpress ka paraqitur vetëm një kartelë teknike për modelin Ricoh Pro C901S, ndërkohë që duhej të paraqiste dy kartela teknike që korrespondojnë me të dyja makineritë e deklaruar në faturë dhe në Formularin e Vetëdeklarimit. Në këto kushte, operatori ekonomik Inpress nuk ka provuar përmbushjen e kriterit të kapacitetit teknik sipas pikës 2.3.8 të Dokumenteve të Tenderit, dhe për rrjedhojë oferta e tij duhet të konsiderohet e papranueshme dhe duhet te skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi.,] Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në shtojcën 9 dhe 10 , pika 2.3.8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 3 (tre) makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet

paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes, ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH

- Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitetjo me pak se prej jo më pak se 1041 fletë A4/ore të printuara nga te dyja anët.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----

E-mail:	-----
---------	-------

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacione për nënkontraktorin
- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e

<p><i>nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime</i> _____ <i>nëse</i> _____ <i>vlerësohet</i> _____ <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë;

¹ Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none">Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____

dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në original ose në kopje të njehsuara.

- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**
- **Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.**

III.2.2. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, 20 sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga

legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; 21 h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.2.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.5. Ndërsa në nenin 41, pika 4 gërma c dhe ç të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 22 b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi. c) operatori ekonomik

ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.


III.2.6. Në përmbushje të kriterit sipërpemdur, operatori ekonomik “Inpress”shpk ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë;


- Shtojca 10. (Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik) FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT I. Unë i nënshkruari Z. xx në cilësinë e Administratorit të Përgjithshëm të operatorit ekonomik Inpress shpk deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Makineri e mjete Po [√] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

OE Inpress shpk., deklaron se: , për realizimin e kontratës, disponon mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: • 3 (tre) makineri/pajisje dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti) nga të cilat 3 (tre) janë me ngjyra dhe 1 (një) Bardhë e Zi, pajisjet si më poshtë vijon: Makineri Printimi Digitale Richoh Pro C901S – me ngjyra- 2 (dy) copë + Skedë Teknike- Pronësi; • Makineri Printimi Digitale Acurio Press C4070 –me ngjyra - 1 (një) copë + Skedë Teknike- Pronësi; • Makineri Printimi Digitale Richoh Pro 8110S –Bardhë e Zi- 1 (një) copë + Skedë Teknike- Pronësi. OE Inpress shpk., deklaron se: makineritë kanë një kapacitet jo me pak se 1041 fletë A4/orë të printuara nga te dyja anët. OE Inpress shpk., deklaron se: disponon sistem kamerash dhe access kontroll. OE Inpress shpk., deklaron se: disponojmë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinim dhe prodhim, të siguruara me kamera sigurie. Objekti është i mbikqyrur nga kamerat e sigurisë CCTV dhe se disponojmë access kontroll. OE Inpress shpk., deklaron se: disponon sistem serverash për perpunimin e të dhënave, në ambjent të mbyllur të survejuar me kamera dhe të ndarë nga ambiente të tjera.

- Gjithashtu Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik ka dorëzuar duhet dokumentat provuese si në vijim:
Fatura me nr. 3023/2022 datë 30.10.2023 Fotokopje Accurio press c 4070;
Fatura me nr. 282/2022 datë 21.02.2022 Makineri /pajisje dixhitale Ricoh Pro C 901S;
Fatura me nr. 904/2022 datë 14.05.2022 Printer Ricoh 8110;

 [18 Skeda teknike Accurio Press C4070 -Inpress shpk.pdf \(6,38 MB\)](#)

 [18 2 Kartela Teknike RICOH Pro 8110s - Inpress shpk.pdf \(11,73 MB\)](#)

 [18 1 Ricoh 901S - Kartela Teknike - Inpress shpk.pdf \(12,99 MB\)](#)

III.2.7. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vihet re, se në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “In press” SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Në rastin konkret, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e DST dhe specifikimet teknike, operatori ekonomik ka deklaruar në formularin e vetdeklarimit se idisponon 3 (tre) makineritë e kërkuara, këto makineri janë të identifikuara në mënyrë katalogëve të ngarkuar në SPE, ku janë përfshirë të dhënat për modelin, dhe të tjera karakteristika teknike relevante që vërtetojnë përputhshmërinë e makinerive me Kriteret e përcaktuara. Duke qenë se operatori ekonomik “Inpress” SHPK është kualifikuar i pari, nga verifikimi i dokumentacionit provues të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, u konstatua se operatori ekonomik disponon mjetet e kërkuara në pikën 2.3.2 të dokumentave standarte të tenderit shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, duke përmbushur kështu kriteret e kualifikimit në lidhje me makineritë.

III.2.8. Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i takon punonjësve dhe pajisjeve të kërkuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pra, në rastin konkret KPP gjykon, se operatori ekonomik “In press” SHPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, si operator ekonomik i kualifikuar i pari, përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit në lidhje me makineritë e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III .3 Lidhur me pretendimin e operatorit ankimues me arsyen se:...[1 N? shtojc?n 6 Formulari i Specifikimeve Teknike jan? dh?n? specifikimet si m? posht?: Specifikimi i Materialeve: SPECIFIKIMET TEKNIKE Printimi i faturës dhe palosje në versionin Selfmailer Formati: A4 Fatura duhet të zarfohet në formën selfmailer me perforim dhe të paloset në formën C Ngjyra: Letra e paraprintuar (Logo kryesore në të dyja krahet e faturës si dhe reklama në pjesën e mbrapme) të jetë me ngjyra dhe të dhënat e tjera. Imazhi i letrës mund të ndryshojë çdo tre (3)

muaj. Gjithashtu shuma debitore dhe teksti që e shoqeron si dhe fjala Debitor duhet të jetë me ngjyrë të kuqe (për klientët debitorë). Të dhënat e tjera të faturës me ngjyrë të zezë. Fatura duhet të ketë dy linja perforimi përgjatë gjatësisë së faturës për hapjen e zarfit si edhe instruksionet përkatëse për hapjen e zarfit. Ngjitje nga krahet anësore. Perforim horizontal tek linja e treguar. Cdo faturë, në pjesën anësore mbrapa duhet të ketë numrin serial të lotit të fileve, zonën dhe numeratorin për zonë. Bashkëngjitur edhe një simulim se si duhet fatura (debitore). Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: SHRUKD sh.a do të dërgojë filen për imazhin e letrës së parashtypur 30 ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit. Ky imazh mund të ndryshojë cdo muaj. Brenda 2 ditësh nga momenti i marrjes së këtyre të dhenave operatori duhet të përfundojë shërbimin e printimit dhe zarfimit. Në dokumentet e procedurës së prokurimit, Enti Prokurues ka përcaktuar qartë kërkesat lidhur me mënyrën e realizimit të shërbimit të printimit dhe zarfimit të faturave. Sipas specifikimeve teknike, SHRUKD sh.a do të dërgojë file-in për imazhin e letrës së parashtypur 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të ciklit të radhës së printimit, ndërkohë që ky imazh mund të ndryshojë çdo muaj në varësi të kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Gjithashtu është përcaktuar se brenda 2 (dy) ditëve nga momenti i marrjes së të dhënave, operatori ekonomik duhet të realizojë dhe përfundojë procesin e printimit dhe zarfimit të faturave. Ky afat shumë i kufizuar kohor kërkon që operatori ekonomik të disponojë kapacitete reale teknike, linjë të specializuar prodhimi dhe eksperiencë konkrete në prodhimin e faturave selfmail, pasi procesi përfshin disa faza teknologjike të lidhura me njëra-tjetrën, si: printimin e të dhënave variabël, përpunimin e letrës selfmail, palosjen dhe mbylljen automatike, si dhe organizimin sipas zonave të shpërndarjes. Nga informacionet dhe verifikimet që disponojmë, rezulton se shoqëria Inpress nuk ka realizuar më parë një procedurë të tillë prodhimi, e cila kërkon organizim të avancuar teknik dhe eksperiencë specifike në prodhimin e faturave selfmail, që përbëjnë një proces të veçantë prodhimi dhe kontrolli cilësie. Për këtë arsye kërkojmë që kampionet e paraqitura nga operatori ekonomik Inpress të analizohen në një laborator të specializuar, me qëllim verifikimin objektiv të përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor sepse jemi të bindur se operatori ekonomik Inpress nuk i ka përmbushur specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit për k? t? arsye k? rkojm? q? KPP-ja t? t? rheqi kampionet e firmes Inpress . Shoqëria jonë ka eksperiencë të gjatë në prodhimin e faturave selfmail, duke realizuar një pjesë të konsiderueshme të këtij shërbimi në nivel kombëtar. Për këtë arsye, jemi plotësisht të ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka cilësia dhe struktura teknike e faturës së ujit, e cila përbën një dokument me rëndësi të veçantë për funksionimin normal të procesit të faturimit dhe shpërndarjes tek abonentët. Nga informacionet që ne kemi, kampionet e paraqitura nga operatori ekonomik Inpress nuk janë realizuar sipas kërkesave të specifikimeve teknike, duke treguar qartë se modeli i paraqitur nuk është në përputhje me standardin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Në këto kushte, kërkesa për paraqitjen e kampioneve në dokumentet e tenderit ka pikërisht si qëllim krijimin e bindjes së plotë tek Autoriteti Kontraktor se operatorët ekonomikë ofertues janë realisht në gjendje të prodhojnë produktin sipas specifikimeve teknike të kërkuara, por kjo nuk është realizuar. Në rastin konkret, kampionet e paraqitura nga operatori ekonomik Inpress nuk krijojnë këtë bindje, pasi ato nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit në të gjitha specifikimet e dokumentave të tenderit. Në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik dhe parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktor ka detyrimin të verifikojë në mënyrë objektive përmbushjen e specifikimeve teknike

dhe të mos pranojë oferta që nuk përputhen me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për sa më sipër, kërkojmë që kampionet e paraqitura nga operatori ekonomik Inpress të analizohen në mënyrë të detajuar nga nje laborator i licensuar, pasi kemi bindjen e plotë se nuk plotësojnë kushtet specifikeve teknike të kërkuara, duke e bërë ofertën e këtij operatori ekonomik të papranueshme. Përsa thotë m' lartë, firma Inpress nuk i ka kampionet e dorëzuara sipas të gjitha specifikeve teknike dhe duhet të skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi .], Komisioni vë re se ,

III.3.1 Autoriteti në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit ka parashkuar si në vijim në pikën 2.4.1 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim;

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë 10 (copë) fatura sipas të gjitha specifikeve teknike të kërkuara në detyrë, në datën dhe orën e caktuar si afat i fundit për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III 3.2 Në përmbushje të kriterit operatori ekonomik “Inpress” shpik ka përcjellë në autoritetin kontraktor dokumentacionin e kërkuar (mostrat), të cilat janë përcjellë me procesverbal shoqëruar, nëpërmjet autoritetit kontraktor në Komisionin e prokurimit publik, me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 744/1, datë 10.04.2026) si në vijim:

III.3.3 Sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.4.1 Operatori ekonomik ka paraqitur 10 (copë) fatura. Nga ku rezulton referuar kërkesave të përcaktuara në shtojcën e specifikeve teknike si dhe referuar verifikimit të mostrave si dhe nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik

III.3.4. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3: 19 - Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

III.3.5. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij lidhur me kërkesat e sipërcituara të autoritetit kontraktor, ankimesi duhet të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Konstatohet se operatori ekonomik ankimesi nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime a-priori dhe të përgjithshme në lidhje me kriteret në fjalë. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit

90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kërkesat e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë i mbështet dyshimet e tij lidhur me kërkesat e parashikuara në shtojcën e specifikimeve teknike . Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese se ku bazohen këto pretendime. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP. KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

III.3.6. Për më tepër rezulton se argumentat e ankimuesit lidhen me një procedurë të mëparshme të zhvilluar nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 110, pika 2 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Ndërsa në nenin 118 pika 2 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, parashikohet: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose 20 entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. Nga interpretimi në tërësi i dispozitës së sipërcituar, del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë, për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Gjithashtu, në nenin 118 të LPP, Komisioni i Prokurimit Publik, ndër të tjera, në vendimmarrjen e tij, mund të pranojë ankesën e operatorit ekonomik dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose

vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, ose të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore. Gjithashtu, në mbështetje të dispozitave të mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Duke u rikthyer te rasti konkret rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk ka përcaktuar se cilën nga specifikimet teknike nuk ka përbushur operatori ekonomik “Inpress” shpk për vet faktin kjo kërkon një investim të caktuar për mostrën e cila do të dërgohet në laborator, duke vijuar më tej, kur operatori ekonomik nuk mbështet pretendimin e tij me prova të dokumentuara dhe nuk përcakton në mënyrë të qartë parametrat ose karakteristikat për të cilat duhet të dërgohet mostra në laborator, autoritetet kompetente nuk mund të kryejnë verifikimin e pretendimeve sipas kërkesave ligjore dhe standardeve teknike.

Mungesa e informacionit të saktë të mbështetur ne fakte mbi parametrat ose specifikimet teknike të cilat nuk përbushin mostrat, përbën pengesë për kryerjen e analizave të duhura dhe rrit mundësinë e rezultateve të pasakta ose dhe të pavlefshme.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

IV. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi operatorin ekonomik “Albdesign” Shpk në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi Komisioni vlerëson se , për sa kohë operatori ekonomik rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit si dhe gjithashtu për sa kohë nuk ka paraqitur ankesë për procedurën objekt prokurimi, Komisioni gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik nuk merren në shqyrtim.

V. Lidhur me shkresën me objekt *shtesë ankese e shoqërisë “ADEL CO” shpk* paraqitur nëpërmjet shërbimit postar për procedurën objekt – ankimi protokolluar me tonën me nr. 744/3, datë 13.03.2026, me objekt *“Shtesë ankese e shoqërisë ADEL CO shpk”*, Komisioni vlerëson se referuar datës së përcjellë datë13.03.2026 si dhe referuar datës së publikimit njoftim fituesit paraprak datë 27.02.2026 Komisioni gjykon te mos merren në shqyrtim për sa kohë janë jasht afatit ligjor të parashikuar nga ligji.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ADEL CO ” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e larte monetar – shërbime – marrëveshje kuadër me 1 operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73202-12-23-2025, me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të SHRUKD”, me fond limit 25.097.400,00 (Njëzet e pesë million e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Durrës sha.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e finances, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ADEL CO ” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

